



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT

Tiranë më, 15.10.2025

THIRRJE PËR APLIKIM PËR STUDENTË ERASMUS+

Në kuadër të projektit Erasmus+ KA171 midis Universitetit të Milanos (UMIL), në Itali dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës, shpallet thirrja për aplikime për lëvizje studentësh, gjatë **semestrit të dytë të vitit akademik 2025-2026**.

Në këtë projekt ftohen të aplikojnë studentët nga:

Fakulteti	Cikli	Kuota
Mjekësisë Veterinare	<i>Bachelor & M. Sc.</i>	1
	Doktoratë	1
Bujqësisë dhe Mjedisit	<i>Bachelor & M.Sc.</i>	3
	Doktoratë	1
Bioteknologjisë dhe Ushqimit	<i>Bachelor & M.Sc.</i>	4

Dokumentet e nevojshme për aplikimin duhet të dërgohen me email në adresën elektronike erasmusoffice@ubt.edu.al:

1. Fotokopje dokumenti identifikimi (pasaportë ose kartë identiteti);
2. *Curriculum Vitae*;
3. Listë e përditësuar e notave;
4. Letër motivimi;
5. Certifikatë zotërimi të gjuhës Italiane ose Angleze (niveli B1 dhe B2 respektivisht)
6. Propozimi i aktivitetit kërkimor (i kërkuar vetëm për studentët doktorantë).

Universiteti Bujqësor, si institucioni dërgues, bën përzgjedhjen paraprake të studentëve aplikues bazuar në performancën akademike dhe njohuritë e gjuhës së huaj. Bursa është 850 Euro/muaj, plus 275 Euro rimbursim i udhëtimit vajtje-ardhje.

Afati i fundit për aplikim është data: **30 NENTOR, 2025**.